



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:092229
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05605171

AA.nr.259/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A.P, përfaqësuar nga avokat M. G., zona Q., rr.”....”, ..., hyrja ..., nr....-Prishtinë, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK), përfaqësuar nga A. B., për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1142/2022, të datës 14.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e datës 05.04.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1142/2022, i datës 14.03.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.P, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës. Në pikën II. Anullohet Vendimi i të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës A.nr.... datë ... dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i të paditurës, ka ushtruar ankesë, me të cilën e konteston ligshmërinë e tij, për shkak të; shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative dhe kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar, të prishet Aktgjykimi A.nr.1142/2022, të datës 14.03.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, si jo ligjor. Të mbetet në fuqi vendimi A.nr.... i datës ... i KPMSHCK-së si i bazuar në ligj.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet në ankesë, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK), ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se;

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Vendimin nr.... i datës ..., ka refuzuar si të pabazuar ankesën me numër A.nr.... e datës ... e parashtruar nga ankuesi A.P.

Kundër këtij Vendimi, paditësi inicon konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore, në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, me propozim që i njëjti të anulohet si jo ligjor. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor me datë 14.03.2023, në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe e anulon vendimin e të paditurës, dhe lëndën e ka kthyer te e paditura në rishqyrtim dhe rivendosje, me arsyetim ndër të tjera se: Aktvendimi i kontestuar përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Fillimisht gjykata konstaton se me vendimin e atakuar refuzohet ankesa e këtij paditësit, kurse në arsyetim e saj konstatohet se KPMSHCK nuk ka kompetencë lëndore që të vlerësoj ligjshmërinë e akteve të natyrës së tillë dhe se në kuptim të nenit 54 të Ligjit për Zyrtarët Publik, referon dhe kundërshtimin me mjete juridike për çdo veprim apo mosveprim të organit të punësimit në kundërshtim me këto dispozita ligjore. Në këtë kuptim duke marrë parasysh kërkesën si në ankesën e këtij paditësit parashtruar pranë të paditurës e që referohet në trajtimin e ligjshmërisë së pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm duke marrë parasysh elaborimet në ankesë si dhe akt emërimin personal për këtë pozitë, Gjykata konstaton se mbi bazën e kërkesës si në këtë ankesë vendimi i të paditurës fillimisht nuk përmban saktë kërkesën e ankuesit-këtij paditësit, e në këtë kuptim dhe nuk ka vendosur për kërkesën e paditësit, për të vazhduar Gjykata me konstatimin e saj se e paditura në arsyetimin e vendimit referon aktin e Qeverisë në të cilat mbështet Rregullorja nr.01/2022 dhe organizimin e strukturës së Ministrisë sipas kësaj Rregulloreje përderisa në arsyetim konstaton se nuk ka kompetencë lëndore që të vlerësoj ligjshmërinë e akteve të tilla. Në këtë kuptim përderisa me vendimin e të paditurës refuzohet kërkesa kurse në arsyetim konstatohet se nuk ka kompetencë, dispozitivi i tillë nuk është me përmbajtjen e përcaktuar ligjore për faktin se dispozitivi i vendimit duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i plotë, ngase kjo pjesë është ajo pjesë e vendimit nga e cila duhet të shihet qartë se si ka vendosur organi kompetente për çështjen e cila ka qenë objekt i procedimit. Dispozitivi i vendimit nuk është i qartë kur brendia e tij duhet të nxjerrët në mënyre të tërthortë nga arsyetimi i vendimit, marrë parasysh këtu edhe faktin që organi administrativ nuk vendosë fare për pjesën e kërkesës të cilën e arsyeton si të pabazuar. Në asnjë pjesë të vendimit të tij e paditura nuk arsyeton kërkesën e këtij paditësit lidhur me ligjshmërinë e trajtimit të pozitës së Drejtorit të përgjithshëm dhe akt- emërimit në këtë pozitë. Po ashtu nuk shpallet jokombëtar në dispozitiv të vendimit referuar vlerësimit të ligjshmërisë së akteve-rregullores, që po ashtu nuk referohet si e tillë kërkesa në ankesë. Prandaj, kjo gjykatë nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në vendimin e kontestuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm. Gjykata këtu kishte parasysh edhe nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet:” 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të

ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit'', e që dispozitivi i vendimet të atakuar është në kundërshtim me nenin 47 të këtij ligji. E paditura duhet ta këtë parasysh edhe nenin 11 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, referuar provave në shkresat e lëndës dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj, jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të aktgjykimit.

Kolegji i gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm konkludimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë si në aktgjykimin e ankimuar. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore në të cilat bazohet, sepse në bazë të provave të administruara gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit përfundimtar në procedurë administrative si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, konstatohet me të drejtë se i njëjti përmban të meta esenciale, dhe nuk është i plotë dhe përmbajtjesor ashtu si parashihet me dispozitat ligjore të LPPA-së, si në nenet 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Organi i paditur është dashur, që pas shqyrtimit të ankesës së paditësit, të nxjerr aktvendim ashtu si parashihet me nenet e lartcekura të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke i shqyrtuar dhe potencuar theksimet dhe pretendimet në ankesë. Aktvendimi do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjet faktike, bazën ligjore në të cilat bazohet akti andaj për shkak të metave të tilla nuk mund të vlerësohet si vendim i drejtë dhe ligjor.

Kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur drejtë, duke e kthyer çështjen në rivendosje te e paditura. E njëjta në ri procedurë duhet të shikoj drejtë dhe saktë gjendjen faktike, si dhe të zbatoj të drejtën materiale, dhe në fund të nxjerrë vendim duke u mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji gjen se bazuar në provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë, ka vendosur drejtë dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për faktet vendimtare dhe baza ligjore në të cilën bazohet aktgjykimi për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, sepse e paditura ka vepruar në kundërshtim me Ligjin.

Organi i paditur me të drejtë dhe bazë ligjore, nga gjykata e shkallës së parë obligohet si në vështrim të nenit 65 të LKA-së, që në ri procedurë pas administrimit të provave të nevojshme, e duke ju përmbajtur vërejtjeve edhe sugjerimeve të gjykatës të vendos në këtë çështje juridike të paditësit, me aktvendim përmbajtjesor të bazuar në prova dhe ligj ashtu si parashihet me dispozita të LPPA-së, dhe dispozita ligjore të cilat e rregullojnë, çështjen e objektit të kërkesës së paditësit.

Pretendimet ankimore të paditurit nga bazat ankimore të cekura më lartë, Kolegji i shqyrtoi në tërësi dhe i vlerëson se janë të pa bazuara, jo të qëndrueshme apo me ndikim për vendosjen e çështjes në mënyrë tjetër, sepse nuk argumentohet me asnjë provë se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës administrative dhe kontestimore, siç pretendohet, sepse nga gjykata e shkallës së parë, janë treguar dhe arsyetuar në tërësi faktet vendimtare të bazuara edhe në bazat ligjore. Nga këto fakte rezulton se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, në bazë të pretendimeve të palëve si dhe provave materiale të gjendjes konkrete, lidhur me çështjen kontestuese mes palëve.

Numri i lëndës: 2022:092229
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05605171

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 i LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.259/2023, me datë 03.04.2024

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi